



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 88, Datë 19.05.2020

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT DHE PAJISJEN ME
ÇERTIFIKATË TË GARANCISË SË ORIGJINËS PËR IMPIANTIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE HEC “BANJË”, TË SHOQËRISË “DEVOLL
HYDROPOWER” SHA**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”i ndryshuar; nenit 16 të Ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; neneve 7 dhe 8 të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.229, datë 20.12.2019 dhe nenit 19 gërma d) të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.05.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licensimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me fillimin e procedurës për kualifikimin e impiantit dhe pajisjen me “Çertifikatë të garancisë së origjinës” për impiantit e prodhimit të energjisë elektrike “HEC Banjë”, të Shoqërisë “Devoll Hydropower” sha,

Konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 684 prot, datë 07.05.2020, shoqëria “Devoll Hydropower” sha, ka paraqitur kërkesë për t’u pajisur me “Çertifikatën e garancisë së origjinës” për impiantit e prodhimit të energjisë elektrike “HEC Banjë”.
- Në zbatim të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Devoll Hydropower” sha, rezulton si më poshtë:
 - Aneksi 1.- Format i aplikimit, gërmat a), b), c). Është plotësuar pjesërisht. Mungon autorizimi ose prokura e përfaqësimit të shoqërisë në këtë aplikim.

- Neni 7, pika 7.4, -Kërkesa për lëshimin e garancisë së origjinës, gërmat a), b), c), ç), d), e), ë), f), g). Është plotësuar tërësisht.
 - Neni 7.5 Dokumentacioni teknik, pika 1, gërmat a), b), c), d); pika 2, gërmat a), b), c). Është plotësuar tërësisht.
 - Neni 8 Procedura teknike e kualifikimit, pikat 8.1, 8.2, 8.3 gërmat a), b), c) dhe d) si dhe pika 8.4. Janë plotësuar tërësisht
- Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me autorizimin ose prokurën e përfaqësimit të shoqërisë nga përfaqësuesi ligjor në bazë të nenit 35 të “Kodit të Procedurës Administrative” (KPrA), do t’i kërkohet shoqërisë plotësimi brënda afateve të përcaktuara në “*Rregulloren për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme*”, miratuar nga bordi i ERE-s me vendimin nr.229, datë 20.12.2019”.

Për gjithë sa mësipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për kualifikimin e impiantit dhe për pajisjen me “*Çertifikatë të garancisë së origjinës*” për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike “HEC Banjë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sha.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI